



BULETINI

Botimi Nr.

01


MUJOR SHKURT 2026



القمة العالمية للحكومات
WORLD GOVERNMENTS SUMMIT



FUTURE
FIT
جاهل للمستقبل
GLOBAL

**4 SHKURT**

Vlerësimi në World Government Summit 2026

Ministrja e Ekonomisë dhe inovacionit, Delina Ibrahimaj, përfaqëson qeverinë shqiptare në Dubai, ku Shqipëria u vlerësua me Future Fit Seal- Global Edition Award për Diellën, ministren e parë me inteligjencë artificiale, si model inovativ qeverisjeje që rrit transparencën, efikasitetin dhe shërbimet publike.



4 SHKURT

Pjesëmarrja në panelin “GovTech for the Benefit of People and Businesses”

U prezantua qasja e Shqipërisë për shërbime digjitale të orientuara te përdoruesi, nxitjen e inovacionit dhe lidhjen e investimeve teknologjike me rezultate ekonomike.



4 SHKURT

Marrëveshja Shqipëri–Slloveni për punësimin dhe sigurimet shoqërore

Marrëveshja forcon bashkëpunimin, mundëson bashkimin e periudhave kontributive dhe siguron të drejta të barabarta në tregun e punës në të dy vendet.



5 SHKURT

Forumi Ekonomik Shqipëri–Slloveni & MoU AIDA–Spirit Slovenia

Forumi krijoi mundësi të reja partneriteti dhe u nënshkrua Memorandumi për bashkëpunim në informacione, aktivitete të përbashkëta dhe nxitjen e investimeve.



6 SHKURT

Ministrja Ibrahimaj takim me Kryeministrin e Katarit

U diskutua forcimi i marrëdhënieve dhe mundësitë për investime në inovacion, teknologji dhe zhvillim të qëndrueshëm.



9 SHKURT

Prezantimi i Kryeinspektorit të ri të Përgjithshëm

Në prani të Kryeministrit Edi Rama, Dashnor Sula u prezantua si drejtues i ri i Inspektoratit Qendror, me fokus profesionalizmin, transparencën dhe partneritetin me biznesin. U diskutuan hapat përfundimtarë të reformës së inspektimeve, e cila ka hyrë në fazë të avancuar konsolidimi.



12 SHKURT

Meet Up Durana – Workshop për zhvillimin e parkut teknologjik

U mblodhën ide për mobilitetin dhe hapësirat e punës; “Durana Tech Park” po konsolidohet si ekosistem inovacioni me mbi 55 rezidentë.



13 SHKURT

Pritja për 65-vjetorin e Pavarësisë së Kuvajtit

Pjesëmarrje në ceremoninë zyrtare përvjetore të Kuvajtit.



17 SHKURT

Prezantimi i Drejtorit të ri të AKSHI-t

Igli Tafaj u prezantua si drejtues i ri i AKSHI-t për të vijuar transformimin digjital të Shqipërisë.

REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E EKONOMISË
E INOVACIONIT



18 SHKURT

Takimi me Ministrin francez Nicolas Forissier

U diskutua marrëveshja ndërqeveritare dhe
plani i veprimit për inovacion.



18 SHKURT

Forumi Ekonomik i Korridorit VIII

Ministrja Ibrahimaj theksoi rëndësinë strategjike e Korridorit VIII për lidhshmërinë dhe pozicionimin e Shqipërisë si nyje lindje-perëndim dhe impaktin pozitiv që do të ketë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe rajonit.



19 SHKURT

Interpelanca për projektin Durana

Ministrja Delina Ibrahimaj në interpelanë në Kuvend sqaroi se në fazën virtuale nuk ka lehtësira doganore dhe asnjë përfitues; projekti synon nxitjen e inovacionit sipas ligjit të vitit 2022.



20 SHKURT

Takimi Cashless Albania

Gjatë një takimi me grupet e interesit, Ministria Ibrahimaj rikonfirmoi se sektori privat duhet të jetë gati për përshpejtimin i pagesave elektronike, zgjerimin e metodave të pagesës dhe ulje të kostove ndërbankare.



23 SHKURT

Forumi Japoni–Shqipëri

Zv.ministri Enkelejd Musabelliu theksoi mundësitë e bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimi i përvojave mes dy vendeve si një proces që tashmë është konkret.



23 SHKURT

Ibrahimaj takim me Ministrin polak të Financave

U diskutua forcimi i partneritetit ekonomik dhe rritja e investimeve mes dy vendeve.



24 SHKURT

Marrëveshja e sigurimeve shoqërore me Poloninë

Marrëveshja garanton njohjen e periudhave të sigurimit dhe të drejtat e pensionit për qytetarët shqiptarë e polakë.



26 SHKURT

Mbledhja e Grupit Parlamentar

Ministrja Ibrahimaj prezantoi një analizë të ecurisë ekonomike me rritje të qëndrueshme që prej vitit 2021.

FORUM

ME NË PROKURIMET PUBLIKE DHE PËRDORIMI I AI NË PROCES



27 SHKURT

OBP zhvillon Forum me Shoqatat e Biznesit

U nënvizua rëndësia e pjesëmarrjes së bizneseve në prokurimet publike dhe përdorimi i AI në procese.



27 SHKURT

Lançimi i Skemës Grant 2026

Ministrja e MEI, Delina Ibrahimaj, në një takim me të rinjtë prezantoi mbështetjen për startup-et me 300 milion lekë për 2026 dhe objektiva afatgjata deri në 2030.